



Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 4, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2019, nxori këtë:

UDHËZIM PËR SHITJEN E PRODUKTEVE TË SIGURIMEVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktohet statusi i punonjësve të siguruesve përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve dhe kriteret minimale për angazhimin e tyre, si dhe të rregullohet mënyra e shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia nga punonjësit e siguruesve dhe ndërmjetësuesit e licencuar të sigurimeve.
2. Ky udhëzim aplikohet për siguruesit, përfshirë degët e siguruesve të jashtëm.
3. Neni 2 dhe neni 3, paragrafët 1 dhe 3, të këtij udhëzimi aplikohen edhe për Byronë Kosovare të Sigurimeve, sa i përket punonjësve të saj përgjegjës për shitjen e sigurimit kufitar nga autopërgjegjësia. Neni 4 i këtij udhëzimi aplikohet edhe për ndërmjetësuesit e sigurimeve, sa i përket shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Neni 2

Statusi i punonjësve të siguruesve përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve

Punonjësit e siguruesit përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve duhet të jenë në marrëdhënie të rregullt pune me siguruesin dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës në pajtim me ligjin e punës në fuqi, kontratën e përgjithshme kolektive, kodin e etikës dhe aktet normative të siguruesit në të cilin janë të punësuar.

Neni 3

Kriteret për punësimin e punonjësve përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve

1. Siguruesit dhe Byroja Kosovare e Sigurimit duhet të sigurojnë që punonjësit përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve i plotësojnë kriteret si në vijim:

- 1.1 të kenë të kryer shkollimin e mesëm.
 - 1.2 të kenë kaluar me sukses provimin profesional për klasën përkatëse të sigurimeve, sikurse përcaktohet me nenin 14 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.
 - 1.3 të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg.
2. Punonjësit përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve, duhet të ndjekin edukim të vazhdueshëm profesional prej së paku dhjetë (10) orë brenda vitit, në kuptim të nenit 14 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.
 3. Siguruesit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve obligohen që brenda dhjetë (10) ditëve pas përfundimit të çdo muaji, të sjellin në BQK për qëllime njoftimi, listën e punonjësve të tyre përgjegjës për shitjen e produkteve të sigurimeve. Kjo listë mund të dërgohet e skanuar edhe përmes postës elektronike.

Neni 4

Mënyra e shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia

1. Sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia shitet përmes sistemit online.
2. Shitja e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia do të bëhet nga punonjës të siguruesit që plotësojnë kriteret sipas nenit 3, paragrafi 1, të këtij udhëzimi si dhe nga ndërmjetësues të licencuar nga BQK-ja sipas Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve të Sigurimeve.
3. Me rastin e angazhimit të një punonjësi apo ndërmjetësuesi të sigurimeve, për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, siguruesi duhet të kërkojë, nga kompania përkatëse e shërbimeve softuerike, lëshimin e emrit të përdoruesit dhe kodit specifik për secilin punonjës ose ndërmjetësues të sigurimeve. Një kopje e kërkesës së njëjtë për qëllim njoftimi i dërgohet edhe BQK-së. Në rastin e punonjësve, kërkesës për lëshim të emrit të përdoruesit dhe kodit duhet t'i bashkëngjitet një kopje e kontratës së punës, ndërsa në rastin e ndërmjetësuesve, kërkesës duhet t'i bashkëngjitet kopja e kontratës së ndërmjetësimit dhe kopja e miratimit të licencimit të ndërmjetësuesit e lëshuar nga BQK-ja.
4. Emri i përdoruesit dhe kodi specifik i lëshuar nga kompania përkatëse e shërbimeve softuerike, duhet të përdoret vetëm nga punonjësi ose ndërmjetësuesi për të cilin është lëshuar. Është e ndaluar bartja e emrit të përdoruesit dhe kodit të punonjësit ose ndërmjetësuesit te persona tjerë.
5. Shitja e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia do të bëhet vetëm në objektet (zyrat) të cilat janë miratuar paraprakisht nga BQK-ja, në pajtim me Rregulloren për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Siguruesve dhe Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.

Neni 5
Masat administrative

Çdo shkelje e dispozitave të këtij udhëzimi do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Sigurimet.

Neni 6
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi do të shfuqizohet Urdhëresa Nr.016/2016 e datës 27 qershor 2006, e lëshuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (paraardhëse e BQK-së), si dhe çdo udhëzim apo urdhërese tjetër që bie në kundërshtim me këtë udhëzim.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 korrik 2019.

Fehmi Mehmeti

Kryesuesi i Bordit Ekzekutiv